



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.

e-mail:contact@pallatirinise.com

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, bazuar në Rregulloren Nr. 1/1373 të datës 22.11.2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të N.P.L "Pallati i Rinisë" Sh.a dhe Plotësim ndryshimi i Rregullorës Nr.1/2017 të datës 28.10.2025 dhe Rregulloren për Marrëdhënien e Punës me Nr. 1/1338 data:14.11.2024 në N.P.L "Pallati i Rinisë" Sh.a, si dhe të Statutit të N.P.L "Pallati i Rinisë" Sh.a Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.L Pallati i Rinise Sh.a. – Prishtinë, me datë:27.07.2026 nxjerrë këtë:

V E N D I M

- 1.ANULOHEN** konkurset publike për pozitat "Udhëheqës/e i/e Zyrës për Kulturë dhe Sport " dhe Shef/e i/e Kabinetit të Kryeshefit Ekzekutiv nga një (1) pozitë pune.
- 2. Shfuqizohet** Vendimi me nr. 1/1579 të datës 14.07.2026 për themelimin e Komisionit për vlerësimin e pozitave sipas konkursit në pikën 1 të këtij vendimi.
- 3. Obligohet** Zyra e Burimeve Njerëzore në zbatim të këtij vendimi të bëjë njoftimin publik për anulim të konkursit përfshirë edhe njoftimin e palëve eventuale të përfshira.
- 4. Vendimi hyn në fuqi** ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Më datë 10.07.2026 N.P.L Pallati i Rinisë Sh.a. ka shpallur konkursin publik me nr. 1/1553 dhe 1/1547 për pozitat "Udhëheqës/e i/e Zyrës për Kulturë dhe Sport " dhe Shef/e i/e Kabinetit të Kryeshefit Ekzekutiv nga një (1) pozitë pune derisa më datë 24.07.2026 është mbyllë konkursi në fjalë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të publikuar për konkurset për pozitat "Udhëheqës/e i/e Zyrës për Kulturë dhe Sport" dhe "Shef/e i/e Kabinetit të Kryeshefit Ekzekutiv", ka konstatuar se gjatë publikimit të konkurseve janë evidentuar mospërputhje dhe gabime teknike në përmbajtjen e kriterëve dhe dokumentacionit të përcaktuar për procedurën e rekrutimit.

Në veçanti, në Pikën V - "Specifikimi i dokumenteve/ dëshmive përkatëse për vërtetimin e përmbushjes së kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës", janë evidentuar paqartësi dhe mospërputhje që mund të ndikojnë në mënyrën e aplikimit, verifikimit dhe vlerësimit të kandidatëve.

Duke u bazuar nga kjo që është cekur më lartë vendoset si në dispozitiv të këtij vendimi.

Konkursi për pozitat e lartëcekura do të rishpallet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes.

Këshilla juridike :Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në Komisionin e Ankesave, në afat prej 7 ditëve , nga dita e pranimit të vendimit.

Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.L Pallati i Rinisë Sh.A.-Prishtinë


Shpend Bilali



Vendimi u dërgohet:

- Arkivit të N.P.L Pallati i Rinisë Sh.a;
- Zyrës së Burimeve Njerëzore;
- Anëtarëve të Komisionit Vlerësues